

Komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn

Milan (Milomir) Živić

(25.05.1925, serb nga Dërvari/Drvare, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, pensionist, dy fëmijë)

Para pensionimit, Milani i moshuar kishte punuar si pylltar. Jetonte me bashkëshorten Ljubica, në shtëpinë e pylltarit në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*, afër fshatit Dërvarë/Drvare. Në muajin maj të vitit 1998, derisa Ljubica ishte në spital, Milani çdo natë e kalonte te djali i tij Sima në Obiliq/Oblič, kurse ditën kthehej në shtëpi. Në datën **28.05.1998**, ai vdiq si pasojë e goditjes në kokë me një mjet me teh të çmprehur, në afërsi të shtëpisë [**Dërvarë/Drvare**]. Të nesërmen, trupin e tij e kishte gjetur policia. U varros një ditë më vonë në varrezat në Obiliq/Oblič.

Burimet: deklarata L.J.S, FDH-31706; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, III, 360; *Ubijen penzionisani šumar Milan Živić*, Politika, 30.05.1998, FDH-34252; KMKMRF, *Personat...*, FDH-10832; *Dnevnik od 25. maja do 1. juna*, Ilustrovana politika, 06.06.1998, FDH-16958.

Ratomir (Stojan) Miljković -

Ratko

(1.06.1941, Serb nga Pantina/Pantina, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, vinçier, shtatë fëmijë)

Čedomirka (Đurica Jokanović) Miljković

(25.12.1945, serbe nga Pantina/Pantina, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, amvise, shtatë fëmijë)

Ratomiri dhe Čedomirka jetonin me djemtë Radovanin dhe Draganin, si dhe vajzat Snežana dhe Dragana. Vëllai i Ratomirit,

Damjani, jetonte në afërsi të tyre. Përveç tyre, në Pantinë/Pantina gjendeshin edhe 11 shtëpi serbe. Serbët organizonin rroje rreth shtëpive serbe.

Në natën në mes të datës 24 dhe **25.06.1998**, ndaj shtëpive serbe ishte hapur zjarr. Në atë çast, Čedomirka dhe Ratomiri gjendeshin në shtëpinë e tyre. Në atë kohë, djali i vogël dhe vajza gjendeshin në Leposaviq/Leposavić, djali Radovani në rrojë, kurse vajza Snežana te Damjani. Të shtënat dëgjoheshin gjatë tërë natës. Në mëngjes, rreth orës 7:00, Ratomiri vendosi për të biseduar me shqiptarë, me qëllim që të gjithë serbët ta braktisnin fshatin në mënyrë të qetë. Ai u nis me një komshi shqiptar. Nga ai çast, Ratomirit i humbët çdo gjurmë. Më pas, shtëpia e Damjanit u rrethua. Kishte edhe burra me uniforma të UÇK-së. Shtënin dhe gjuanin bomba mbi shtëpinë e Damjanit. Më pas, dy persona [identiteti i njërit është i njohur për FDH], kishin shkuar te shtëpia e Ratomirit, e rrënuan derën, e nxorën Čedomirken jashtë dhe ia vunë zjarrin shtëpisë. Čedomirken e sollën deri te shtëpia e Damjanit. Fëmijët e Čedomirkes dhe persona të tjerë që fshiheshin në shtëpinë e Damjanit i dëgjuan britmat e saj dhe kërkesën që të mos dorëzoheshin. Čedomirkën e dërguan në drejtim të *Mëhallës Seliović* [**Pantinë/Pantina**]. Nga ai çast, asaj i humbet çdo gjurmë. Në regjistrin e KNKK-së, rasti i saj i zhdukjes është sistemuar me numër YUK-050057-02. Ekipi i Zyrës së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur, më 19.08.2002, i ka zhvarrosur mbetjet mortore të Ratomirit në pyllin e fshatit Vrboc/Vrbovac [Gllgoc/